



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT**

AN281020220007

Tiranë, më: 22.11.2022

**Komisioni 91**

**DEKLARATË MJEDISORE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

**VENDOSI:**

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Person Juridik:** “**BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD**”

**Nr. NIPT-i:** K43128401L

**Adresa e selisë:** Lagjja "Sheq i Madh", Rruga "Leonardo Murialdo", Godina nr.37, Fier.

**Personi përgjegjës:** Huanqin Xiao

Për të zhvilluar projektin: “**Rehabilitim sheshi, ndërtim Impianti për trajtimin e mbetjeve të naftës dhe magazinë për depozitimin e materialit të trajtuar.**”

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Instalimet për asgjësimin e mbetjeve.

**Vendndodhja:** Marinëz, Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec, Qarku Fier.

**Të dhëna teknike:**

Sipërfaqja totale e projektit 31357 m<sup>2</sup>

Sipërfaqe magazine 5332 m<sup>2</sup>

Sipërfaqe impianti 4092 m<sup>2</sup>

Kapaciteti përpunues i impiantit 30,000 ton/vit

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin I me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit, aneksi II. Distancat nga zonat e Mbrojtura)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

## **Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

*Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:* o Sugjerohet që gjatë ndërtimit të veprimtarisë, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve si më poshtë:

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.02.2005, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar;
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar;
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licencë III.2.B , si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “ i ndryshuar;
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.
- Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas Parimit të Përgjegjshmërisë Ndaj Mjedisit, në përputhje të plotë me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin në mënyrë të integruar të mbetjeve.

o Sugjerohet që gjatë zhvillimit të aktivitetit, subjekti të mbajë në konsideratë legjislacionin në fuqi:

- Ligji nr 10463, datë 22/09/2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 81/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura”;
- Vendimit nr. 303, datë 10.5.2019 “Për Miratimin e Listës së Rishikuar, të Përditësuar, të Monumenteve të Natyrës Shqiptare”.

o Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së shfrytëzimit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
- Të spërkatet rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- Të sigurohen struktura brenda sheshit të ndërtimit për larjen dhe pastrimin e automjeteve/rrotave të automjeteve, para daljes nga sheshi i ndërtimit, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.
- o Gjatë fazës së funksionimit, impianti të jetë i pajisur me filtra për kapjen e gazeve në mënyrë që të reduktohen shkarkimet e tyre në ajër.
- o Sugjerohet që gjatë fazës së punimeve ashtu edhe gjatë fazës së funksionimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:
  - Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Menaxhimi i kimikateve”;
  - Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, duhet të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”);
  - Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, duhet të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Menaxhimi i kimikateve”.
- o Sugjerohet që të kryhen punime miqësore me mjedisin dhe të krijohen hapësira të gjelbra përreth.
- o Sugjerohet të zbatohet ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”.
- o Sugjerohet që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet t’i përmbahet legjislacionit në fuqi, specifikisht Ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.
- o Sugjerohet verifikimin nga ana juaj të vlefshmërisë së procesit të realizuar të konsultimit me publikun mbi respektimin e parashikimeve në VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore” në lidhje me afatet ligjore dhe përcaktimet e tjera. Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve etj., të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura:* Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet projekti “Rehabilitim sheshi, ndërtim impianti për trajtimin e mbetjeve të naftës dhe magazinë për depozitimin e materialit të trajtuar”, me vendndodhje në fshatin Marinëz, njësia administrative Kuman, Bashkia Roskovec, Qarku Fier, me zhvillues “BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD” sh.p.k dhe aplikues “GR ALBANIA” me nr. Aplikimi AN281020220007, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

*Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehen, me sugjerime si me poshte vijon:* Projekti propozohet të zhvillohet në Marinzë, në brendësi të zonës naftëmbajtëse Patos-Marinzë, e cilësuar si zonë e industrisë së rëndë të kërkim-zbulimit dhe shfrytëzimit të naftës, një zonë me zhvillim industrial historik.

*Sugjerime:*

- Mbetjet inerte të ripërdoren kur është e mundur ose të largohen rregullisht nga sheshi i ndërtimit duke u depozituar në pikat e caktuara nga Bashkia Roskovec si dhe të trajtohen sipas kërkesave të VKM Nr.575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Zonat hyrëse dhe dalëse nga kantieri duhet të jenë të pajisura me të gjithë sinjalistikën e nevojshme për të shmangur çdo aksident të mundshëm.
- Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor.
- Gjatë transportit të përdoren mushamatë e kamionave për të shmangur përhapjen e dherave e të materialeve inerteve në rrugët lidhëse të zonës.
- Të merren masa për të zvogëluar ose zbutur efektet e zhurmës dhe dridhjeve aty ku ato janë praktike dhe me kosto efektive.
- Të merren masat për lagjen e rrugëve të aksesit në kantier të cilat do të përdoren nga mjetet e tonazhit të lartë duke ulur mundësinë e përhapjes së grimcave të ngurta në mjedis.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të bëhet sistemimi dhe rehabilitimi i vendit të prekur nga punimet në përfundim të punimeve.
- Në rast se do të kemi dëmtim të habitateve të merren masa për rehabilitimin e tij ose zëvendësimin me habitat të ri.
- Të merren masa për zbutjen e ndikimit në peizazh.
- Subjekti duhet të ketë marrë masat e nevojshme që funksionimi i instalimit të bëhet brenda zonës së përcaktuar dhe të mos ndikojë në peizazhin dhe vlerat e zonës.
- Të gjitha veprat hidrike si hidrovore, ura, argjinatura do të duhet të ruhen me prioritet sipas pritshmërisë së qëllimit final të projektit.
- Të kihet parasysh përmirësimi i rrugëve të aksesit, mirëmbajtja e kanaleve kulluese ekzistuese, pajisja e tyre me argjinaturat përkatëse për mbrojtjen e terrenit nga përmytjet.
- Të zbatohen normat e emetimeve në ajër sipas VKM-së Nr.435, datë 12.09.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në “Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Të zbatohet legjislacioni specifik në lidhje me zhurmat dhe me nivelet kufi të zhurmave, duke respektuar nivelet kufi të zhurmës, Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.
- Të zbatohet legjislacioni në fuqi sipas Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* U realizua në datën 20.10.2022. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu siguria të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Kërkesat e pjesëmarrësve, do të mbahen parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.

### **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

- Dokumenti i Gjykatës Nr. 31830/3, datë 17.11.2006, për ndryshimin e emrit, nga Saxon International Energy Ltd-Albania Branch në Bankers Petroleum Albania LTD.
- Kontrate qeraje prone me Nr.BPAL-LL-508-21.
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
- Mendimin e Drejtorive teknike të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.
- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 91, datë 22.11.2022, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.106, datë 19.05.2022, "Një ndryshim në Urdhërin nr.75, datë 13.04.2022, për "Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis".

### **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme.**

- 4.1** Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2** Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3** Kjo deklaratë është e vlefshme pas miratimit nga institucionet përkatëse. Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda sipërfaqjes dhe koordinatave të kërkuara në aplikim.
- 4.4** Subjekti duhet të tregoj kujdes të veçantë me monumentet e natyrës të cilt ndodhen në zonë.
- 4.5** Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.
- 4.6** Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.7** Subjekti të zbatohet me korrektësi kërkesat e Legjislacionit Shqipëtar për mbrojtjen e mjedisit dhe komunitetit.
- 4.8** Para fillimit të zbatimit të projektit në terren, të hartohet Plani i Menaxhimit Mjedisor.
- 4.9** Kompania të ndjek me përpikmëri projektin për të evituar rrëshkitjet e dherave dhe aksidentet e mundshme.
- 4.10** Proçesi teknologjik të kryhet në bazë të studimeve gjeologjike dhe hidrologjike për të shmangur në maksimum dëmtimin e burimeve ujore, devijimin e rrymave ujore, erozionin dhe dëmtimin e zonave përreth.
- 4.11** Proçesi i shpimit të pusit të mos dëmtojë vepra dhe infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe objekteve të tjera në afërsi, barriera mbrojtëse, tubacione ujësjellesi kanale etj.
- 4.12** Ndalohet kategorikisht shkarkimi i mbetjeve në shtratin e lumit në rast se gjenerohen të tilla.

### **Gjatë fazës së instalimit:**

- 4.13** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore

- 4.14 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.15 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.16 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.17 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.18 Të sistemohen brenda sipërfaqjes së shfrytëzimi të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës
- 4.19 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.20 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.21 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 4.22 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.23 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.24 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
- 4.25 **Gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit nr. 60/2014 datë 19.6.2014, "Për një ndryshim në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar, Shtojca I, duhet t'i nënshtrohet procedurave për paisje me Leje Mjedisore.**

## 5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Neni 25/1 "Monitorimi dhe vlefshmëria", zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

### - Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara" dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.

- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi:*

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	22.05.2023	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	22.05.2023	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	22.05.2023	Çdo 6 muaj

**- Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM <sub>2,5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>	22.05.2023	Çdo 6 muaj
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> , 40 µg/m <sup>3</sup>	22.05.2023	Çdo 6 muaj

**- Cilësia e ujrave**

*Parametrat që duhet të monitorohen*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	22.05.2023	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**

**MINISTRI**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**


*Konceptoi:*

*Konfirmoi:*

*Pranoi:*



## Aneksi 1. Harta me koordinatat



**Figura 1. Vëndodhja e zonës ku synohet të zhvillohet projekti**

**Tabela 1: Koordinatat e projektit ne sistemin Gauss Kruger dhe KRRGJSH**

PIKA	Gauss Kruger	KRRGJSH
1	X: 4386714.953	X: 471179.5117
	Y: 4512978.481	Y: 4512089.249
2	X: 4386719.717	X: 471184.5102
	Y: 4512957.834	Y: 4512068.662
3	X: 4386695.365	X: 471160.7549
	Y: 4512905.954	Y: 4512016.516
4	X: 4386699.6	X: 471165.3207
	Y: 4512876.838	Y: 4511987.455
5	X: 4386691.66	X: 471157.659
	Y: 4512852.486	Y: 4511963.018
6	X: 4386654.073	X: 471120.4007
	Y: 4512824.429	Y: 4511934.539
7	X: 4386641.368	X: 471107.9093
	Y: 4512805.9	Y: 4511915.87
8	X: 4386634.486	X: 471101.1675
	Y: 4512793.724	Y: 4511903.618
9	X: 4386544.49	X: 471010.5289
	Y: 4512851.957	Y: 4511960.813
10	X: 4386516.432	X: 470981.9531
	Y: 4512898.014	Y: 4512006.539
11	X: 4386548.483	X: 471013.0519
	Y: 4512980.989	Y: 4512089.86
12	X: 4386573.606	X: 471037.4376
	Y: 4513045.184	Y: 4512154.327




Figura 6. Plani i përgjithshëm i paraqitjes